


# SECURITY FACT SHEET


## Transformimi i FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës




### Buxheti për Ushtrinë e shteteve në rajon

\*Buxheti për Shqipëri, Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi është marr në valutën vendore dhe është konvertuar për qëllim të këtij publikimi.


## Buxheti i FSK-së për 2008 – 2018 (% e GDP)



### Buxheti i FSK-së për periudhën 2009-2018



### Buxheti i FSK-së për periudhën 2019-2028



## Personeli



Personeli; Forcat e Armatosura të Kosovës do të kenë jo më shumë se 5000 pjesëtarë Aktiv dhe 3000 pjesëtarë Rezervë. Personeli do të rekrutohet sipas planit të rekrutimit përgjatë periudhës 10 vjeçare.

## Kohëzgjatja e Zhvillimit dhe arritjes së Kapaciteteve të Plota Operacionale të FSK-se

Kohëzgjatja e Zhvillimit dhe arritjes së Kapaciteteve të Plota Operacionale të FSK-se është për 10 vite do të ndahet në tri Faza Zhvillimore dhe do të jetë e mbështetur në prioritetet dhe e bazuar në kapacitetin buxhetor. Aftësitë Operacionale të FSK-së për mbështetje të autoriteteve civile MUAC (mbështetje ushtarake autoriteteve civile) do të mbahen edhe gjatë periudhës së tranzicionit.

Faza e Parë, që mbulon periudhën kohore një deri në tre vite do të fokusohet në riorganizimin e Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes, Komanden e Forcave Toksore në Shtab të Përgjithshëm të FSK-së si dhe Komandave kryesore të FSK-së. Prioritetet bazë do të fokusohen në ngritjen e kapaciteteve për planifikim të mbrojtjes, trajnim dhe doktrinë, mbështetje logjistike, rekrutim dhe blerje të sistemeve të armatimit. Fillimi i ngritjes së Regjimenteve të Këmbëorisë që do të zhvillohet për misionin e mbështetjes territoriale, do të jetë e shkallëzuar duke filluar me tranzicionin e Brigadës së Reagimit të Shpejtë në Komandën e Forcave Tokësore dhe tre regjimentet e saj. Në këtë fazë Regjimenti i Parë i këmbëorisë do të jetë i gatshëm për kryerjen e operacioneve në mbrojtje të integritetit territorial

3 VITE

Faza e Dytë, që mbulon periudhën kohore katër deri në gjashtë vite (4-6), do të koncentrohet në ngritjen e kapaciteteve përfundimtare trajnuese dhe logjistike me aftësi për mbështetje të Komandës së Forcave Tokësore (BRSH e sotme). Në këtë fazë do të kemi të gatshme Regjimentit e Këmbëorisë në kryerjen e misionit të dhënë. Gjithashtu në këtë fazë FSK do të jetë e gatshme të marrë pjesë në Operacione të Mbështetjes së Paqes me Njësi të caktuara.

4 - 6 VITE

Faza e Tretë, që mbulon periudhën kohore shtatë deri në dhjetë vite (7-10), si përpjekje përfundimtare për të zhvilluar Aftësitë e Mbështetjes Luftarake dhe Mbështetjes Luftarake me Shërbime, Zhvillimin e Gardës Kombëtare dhe vazhdimin e trajnimeve komplekse për të deklaruar Aftësitë e Plota Operacionale.

7-10 VITE

Në fund të fazës së tretë FSK do të jetë e kompletuar me personel aktiv dhe pajisje, si dhe me pjesë të komponentës Rezervë. Njësia e helikopterëve është menduar të dizajnohet si aset kombëtarë që do të jetë nën menaxhimin e FSK-së (financimi do të jetë nga buxheti qendror).

E përgatitur nga Donika Emini  
Hulumtuese në QKSS.